



**Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri**

Public Affairs and Media Office
Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe e Medias

DEKLARATË PËR SHTYP

Prezenca e OSBE-së ndihmon në trajnimin e punonjësve të policisë, gjyqtarëve dhe shoqërisë civile për ligjin kundër dhunës në familje

TIRANË, 18 shtator 2007 – Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ndihmoi në trajnimin e oficerëve të policisë, gjyqtarëve dhe përmbaruesve, si dhe të përfaqësuesve të shoqërisë civile, për Ligjin e ri për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare.

Seminaret, e zhvilluara gjatë dhjetë ditëve të fundit në Shkodër dhe Tiranë, u organizuan në bashkëpunim me Akademinë e Policisë, Ministrinë e Drejtësisë dhe shoqatën për mbrojtjen e grave me qendër në Shkodër “Gruaja tek Gruaja”.

“Sistemi i drejtësisë, si dhe shoqëria civile, luajnë një rol të rëndësishëm në bërjen të mundur që gratë viktime të dhunës në familje të përfitojnë nga mekanizmat mbrojtëse të parashikuara në ligjin e ri”, tha Maya Goldstein, Këshilltare e Lartë për Çështjet Gjyqësore në Prezencën e OSBE-së. “Miratimi i ligjit është një hap i rëndësishëm, por mbrojtja e viktimave të dhunës në familje është po aq thelbësore”.

Seminaret synuan rritjen e ndërgjegjësimit të 140 pjesëmarrësve lidhur me çështjet e dhunës në familje, si dhe informimin e tyre për rregullimet e reja të parashikuara në ligj. Oficerët e policisë, gjykatësit dhe përmbaruesit u njohën me procedurat për kërkimin dhe zbatimin e urdhrave të mbrojtjes kundër dhunuesve, ndërsa përfaqësuesit e shoqërisë civile u trajnuan për dispozitat që kanë të bëjnë me ofrimin e ndihmës ligjore falas për viktimat e dhunës në familje.

Seminaret ishin pjesë e veprimtarive të Prezencës së OSBE-së në kuadër të projektit të quajtur “Aksesi i Grave në Sistemin e Drejtësisë”. Rreth 175 gjykatës, prokurorë dhe avokatë janë trajnuar për ligjin kundër dhunës në familje, që nga prilli 2007.

Prezenca e OSBE-së ndihmoi në hartimin e Ligjit për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare, i pari i këtij lloji në Shqipëri. Ligji u propozua nga shoqëria civile dhe u miratua nga Kuvendi në dhjetor 2006.